

FOL

Monitorimi i
përzgjedhjes
së anëtarëve
të Bordit të

RTK

Titulli: Monitorimi i përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës (RTK)

Lëvizja FOL

Viti i botimit: Janar 2022

Publikuar nga: Lëvizja FOL, Andrea Gropa nr.35 Prishtina 10000, Republika e Kosovës
info@levizjafol.org +386 (0)49 131 542

Të drejtat e autorit © 2022. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
Korniza ligjore	4
Procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të RTK-së.....	7
Hapja e konkursit	7
Faza para intervistave dhe përzgjedhja e kandidatëve për intervistë.....	8
Faza e mbajtjes së intervistave	9
Zgjedhja e bordit të RTK-së nga ana e Kuvendit të Kosovës.....	14
Anex 1 – Lista e poentimit.....	15

Hyrje

Lëvizja FOL është organizatë jo qeveritare, e cila fokus të saj e ka rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në institucionet publike në vend. Që nga viti 2019, Lëvizja FOL ka filluar monitorimin e proceseve të rekrutimit të pozitive të larta shtetërore në Kuvendin e Republikës së Kosovës, qëllimi i të cilit është ndjekja e mbarëvajtjes dhe zhvillimit të procedurave parlamentare, duke ndikuar në ngritjen e llogaridhënies dhe transparencës së këtyre proceseve.

Kosova në shkurt të vitit 2021 hyri në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Këto zgjedhje erdhën si pasojë e dështimit të koalicionit parlamentar mes Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), koalicion ky i dalur nga zgjedhjet parlamentare të muajit tetor 2019. Ndërkaq me 14 shkurt 2021, Lëvizja Vetëvendosje fitoi shumicën parlamentare në këto zgjedhje të parakohshme si dhe formoi qeverinë e vetme. Që nga kjo periudhë, Qeveria e Kosovës ka marr vendime të shumta për shkarkime të ndryshme të anëtarëve të bordeve të institucioneve dhe ndërmarrjeve të ndryshme të Kosovës, disa prej të

cilave janë përcjellë edhe me reagime dhe pakënaqësi nga ana e organizatave të shoqërisë civile.

Vendimet e tilla janë analizuar nga Lëvizja FOL, në mënyrë që të vlerësoj ligjshmërinë e këtyre vendimeve dhe të konstatoj se a janë të bazuara në procedura të rregullta të shkarkimit. Shkarkimet mund të bëhen vetëm në pajtim të plotë dhe të drejtë me dispozitat ligjore, si dhe duke marrë për bazë performancën e dobët të tyre apo edhe për dyshimet për keqpërdorime në pozita të tilla. Po ashtu, është shumë e rëndësishme që rekrutimi në pozita të ngjashme të bëhet përmes konkurseve të hapura dhe në mënyrë sa më transparente. Përveç nivelit të respektimit të dispozitave ligjore, këto veprime të Qeverisë janë analizuar në mënyrë që të vlerësohet gatishmëria dhe vullneti për ushtrimin e pushtetit bazuar në parimet e qeverisjes së mirë.

Në korrik të këtij viti, Kuvendi i Kosovës ka shkarkuar Bordin Drejtues të televizionit publik të Kosovës – Radiotelevizionit të Kosovës (RTK). Shkarkimi i këtij bordi erdhi pas rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike si

dhe Komisionit për Media të Kuvendit të Kosovës. Ky shkarkim u bë me arsyetimin se Bordi Drejtues i RTK-së, në vazhdimësi ka dështuar t'i siguroj qasje të papenguar Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm në inicim dhe kompletim të auditmit të rregullsisë dhe performancës së mediumit publik. Sipas Komisionit, Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës përcakton se është institucion publik, dhe për këtë arsye, duhet të auditohet nga Zyra Kombëtare të Auditimit.

Përzgjedhja e personave meritore dhe kompetent në institucionet publike, e veçanërisht në pozitë të larta shtetërore, duke u bazuar në parimet e transparencës, llogaridhënies dhe barazisë së kandidatëve, padyshim se do të ndikoj në ngritjen e performancës dhe kredibilitetit të institucioneve publike përkatëse.

Prandaj, mbarëvajtja e procesit të rekrutimit të anëtarëve të Bordit të RTK-së në veçanti, përzgjedhja e tyre duke u bazuar në procedurat e hapura dhe transparente të rekrutimit, si dhe niveli i respektimit të afatave dhe dispozitave ligjore në zgjedhjen e këtyre anëtarëve, janë objekt trajtimi i këtij raporti.

Korniza LIGJORE

Në drejtim të etablimit të infrastrukturës ligjore për transmetuesin publik të Kosovës – Radio Televizionin e Kosovës (RTK), Kuvendi i Republikës së Kosovës në gusht të vitit 2008 kishte miratuar Ligjin nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës, të ndryshuar pastaj në prill të vitit 2012 me Ligjin nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës.

Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i informimit të saktë, objektiv, të paanshëm dhe të shpejtë të qytetarëve të Republikës së Kosovës përmes këtij televizioni publik. Në Kreun V të këtij ligji janë përcaktuar organet drejtuese dhe udhëheqëse të Radio Televizionit të Kosovës. Kjo ndërmarrje publike, sipas këtyre dispozitave, përbëhet nga Bordi i RTK-së dhe Drejtori i Përgjithshëm.

Bordi i RTK-së është organ kolegjal-drejtues i RTK-së, që përbëhet nga 11 anëtarë. Anëtarët e bordit të RTK-së, në kuptim të dispozitave të këtij ligji, duhet të jenë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: kultura, arti, kinematografia, gazetaria, drejtësia, biznesi dhe menaxhmenti, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, universiteti, media dhe teknikës. [1]

Sipas dispozitave të këtij ligji, përbërja e Bordit të RTK-së pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës. Së paku 2 anëtarë të Bordit të RTK-së emërohen nga komuniteti serb dhe 1 anëtar emërohet nga komunitetet tjera jo shumicë (së paku 2 anëtarë duhet të jenë të gjinisë femërore). [2]

Ligji ka rregulluar hollësisht edhe çështjen e zgjedhjes dhe mandatit të Anëtarëve të Bordit të RTK-së nga organi kompetent për zgjedhjen e tyre, përkatësisht nga Kuvendi i Kosovës. Komisioni përgjegjës i Kuvendit, pas intervistimit të kandidatëve rekomandon dy (2) kandidatë për çdo pozitë në Bord, për të cilët konsideron se janë më të përshtatshmit në bazë të kompetencave, integritetit dhe përkushtimit të tyre për zhvillimin dhe përparimin e RTK-së. [3]

Sipas Ligjit për RTK-në, kandidatët për Bordin të RTK-së propozohen sipas procedurave të mëposhtme: brenda nëntëdhjetë (90) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të Bordit apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, RTK bënë shpallje publike brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj; pesë (5) ditë pas mbylljes së shpalljes publike, të gjitha aplikacionet RTK ia dorëzon Kuvendit të Kosovës i cili themelon Komisionin Ad - Hoc për shqyrtimin e tyre; brenda periudhës kohore prej prej tridhjetë (30) ditësh

pas përfundimit të afatit për paraqitjen e kandidaturës, komisioni, pas intervistimit rekomandon dy (2) kandidatë për çdo pozitë në Bord, për të cilët konsideron se janë më të përshtatshmit në bazë të kompetencave, integritetit dhe përkushtimit të tyre për zhvillimin dhe përparimin e RTK-së; Bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit, Kuvendi zgjedh njërin nga kandidatët e rekomanduar me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë. [4]

Mandati i anëtarëve të Bordit do të jetë si në vijim: katër anëtarë të Bordit të RTK-së do të emërohen me mandat 2 vjeçar, katër anëtarë me mandat 3 vjeçar dhe tre anëtarë me mandat 4 vjeçar, ndërsa përcaktimi i kohëzgjatjes së mandatit nga secili grup do të bëhet me short. Ndërsa mandati i kryetarit dhe nënkryetarit të Bordit të RTK-së është 2 vite, me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat shtesë. Anëtarët e Bordit, mund të ri-emërohen vetëm edhe për një mandat tjetër 3 vjeçar. [5]. Neni 27 i ligjit trajton çështjen e personave që nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të RTK-së. Këtu përjashtohen anëtarët e familjes së ngushtë të stafit menaxhues; ish punonjësit të punësuar në RTK në 2 vitet e fundit; personat që mbajnë post publik të zgjedhur dhe të emëruar (funksionarët publik) apo personat të cilët kanë qenë në këto pozita gjatë 2 viteve të fundit;

[2] Po aty, neni 25, par. 6.

[3] Neni 26, par. 2,3.

[4] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, neni 26

personat që mbajnë post publik të zgjedhur dhe të emëruar (funksionarët publik) apo personat të cilët kanë qenë në këto pozita gjatë 2 viteve të fundit; është anëtar i organit udhëheqës të një partie politike apo personat të cilët kanë qenë në këto pozita gjatë 2 viteve të fundit; personi i cili është anëtar i organit udhëheqës të ndonjë ndërmarrje publike; ka interes financiar të drejtpërdrejtë ose përfaqëson këtë interes; punon ose ka punuar në ndonjë transmetues në punët e telekomunikimit ose të transmetimit dhe në RTK në 2 vitet e fundit; kandidati të mos jetë i dënuar për vepër penale të dënueshme mbi 6 muaj; pronarët apo bashkëpronarët e mediave transmetuese ose bizneseve reklamuese si dhe anëtarët e familjes së ngushtë të tyre apo edhe të punësuarit në këto media; personi që është i/e angazhuar në aktivitete që mund të konsiderohen të jenë në kundërshtim dhe paraqesin konflikt të interesit siç është përcaktuar me ligjin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit. [6]

Pra sipas kësaj dispozite, anëtarët e ngushtë të stafit menaxhues, personat që kanë punuar në RTK në 2 vitet e fundit, funksionarët publik që kanë qenë në këto pozita në dy vitet e fundit, anëtarët e organeve udhëheqëse të ndonjë ndërmarrjeje publike, personat që kanë qenë të dënuar me më shumë se 6 muaj burg, apo personat e angazhuar në aktivitete që mund të konsiderohen të

jenë në kundërshtim dhe paraqesin konflikt të interesit, nuk mund të jenë pjesë e Bordit të RTK-së.

Në kuptim të dispozitave të këtij ligji, interesi privat i personit zyrtar nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste. Rrjedhimisht, konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare. Prandaj është i rëndësishëm së veçantë që në pozita të larta shtetërore, emërimi i personave të bëhet duke ju shmangur konfliktit të interesit që eventualisht mund të paraqitet.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit gjithashtu përcakton se zyrtarët e lartë publik mund të jenë anëtar të organeve drejtuese, por jo edhe të funksioneve drejtuese, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme, por pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to. [7]

[5] Po aty, par. 3,4 dhe 5.

[6] Po aty, neni 27.

[7] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 06/I -011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, neni 13, par.2.

PROCESI I PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË BORDIT TË RTK-SË

Në tekstin e mëposhtëm do të përshkruhet në mënyrë të detajuar i tërë procesi i përzgjedhjes së 8 anëtarëve të bordit të RTK-së, duke filluar nga hapja e konkursit, e deri tek përfundimi i këtij procesi, si dhe procesin parlamentar të përzgjedhjes dhe votimit të tyre nga ana e deputetëve në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës.

HAPJA E KONKURSIT

Kuvendi i Kosovës me datën 8 korrik 2021 ka shkarkuar 8 anëtarët e bordit të televizionit publik të Kosovës – Radio Televizionit të Kosovës (RTK). Deputetët votuan për shkarkimin e tetë antarëve të bordit, pas rekomandimit të Komisionit Parlamentar për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, dhe kjo nën arsyetimin se anëtarët e bordit drejtues në vazhdimësi kanë dështuar t'i sigurojnë qasje të papenguar dhe të pakontestuar Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm në auditim.

Duke u bazuar në Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës është themeluar i Radiotelevizionit të Kosovës, andaj e ka edhe mundësinë ligjore të shkarkimit të anëtarëve të tij kur ka shkaqe të arsyeshme. Në bazë të nenit 26 të Ligjit të RTK-së, anëtarët e Bordit të RTK-së emërohen po ashtu nga Kuvendi i Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente. Rrjedhimisht, administrata e RTK-së me datën 19 korrik 2021, shpalli konkurs për plotësimin e 8 vendeve të lira për anëtarë të Bordit të RTK-së. Konkursi ka qenë i hapur deri me datën 02 gusht 2021.

Ndërkaq në anën tjetër, Kuvendi i Kosovës me 20 shtator 2021, me 68 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, formoi Komisionin Ad-Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për 8 anëtarë nga komuniteti shqiptarë dhe 1 anëtar nga komuniteti serb në Bordin e RTK-së. Ky komision u përbë nga këta deputetë: Armend Zemaj (kryetar i këtij komisioni) nga rradhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Armend Muja (zëvendëskryetari i parë), Doarsa Kica, Saranda Bogujevci, Ardian Gola dhe Fitim Uka, anëtar të komisionit nga rradhët e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), Mërgim Lushtaku dhe Blerta Deliu – Kodra anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK); Igor Simiq anëtar nga rradhët e Listës Serbe; Albana Bytyçi anëtare nga rradhët e Aleancës për Ardhmërinë e

[81 Po aty, neni 14, par.2.

[9] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, neni 4

Kosovës (AAK) dhe Duda Balje anëtare nga rradhët e Grupit Multietnik.

FAZA PARA INTERVISTAVE DHE PËRZGJEDHJA E KANDIDATËVE PËR INTERVISTË

Pas konstituimit të Komisionit Ad – Hoc nga ana e Kuvendit për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së, Komisioni Ad-Hoc, mbajti takimin e parë me datë 27 shtator 2021. Në mbledhjen e parë të këtij komisioni prezent ishin këta gjashtë deputet: Armend Zemaj (kryetar), Armend Muja (zëvendëskryetari i parë), Fitim Uka, Doarsa Kica – Xhelili, Duda Balje dhe Blerta Deliu – Kodra (anëtarë).

Në mbledhjen e parë të këtij komisioni u diskutua për numrin e personave që kishin aplikuar në këtë konkurs dhe çështje të tjera në lidhje me sigurimin e trasnparencës dhe objektivitetit të procesit.

Në këtë konkurs kishin aplikuar gjithsej 132 kandidatë, 127 kandidatë shqipëtarë si dhe 5 nga komuniteti serb. Mbi 40 % e të gjithë kandidatëve kanë qenë të gjinisë femrore. Anëtarët e komisionit qysh në fillim kanë bërë

thirrje që ky proces të jetë sa më transparent ndaj publikut, mediave si dhe shoqërisë civile. Po ashtu anëtarët e komisionit bënë thirrje që ky proces të mos jetë politik, në mënyrë që së këndejmi bordi i ri të mos jetë i kapur nga politika por të jetë apolitik.

Komisioni Ad – Hoc për përzgjedhjen e Bordit të RTK-së ka mbajtur edhe 3 takime të tjera deri në fazën e intervistave.

Në takimin e datës 8 tetor 2021, komisioni ka diskutuar për listën e kandidatëve për Bord të RTK-së. Në këtë takim është diskutuar se si të bëhet përzgjedhja e listës së ngushtë për bord të RTK-së, krejt kjo duke u bazuar në Ligjin për RTK-në, respektivisht nenit 27 të këtij ligji, i cili qartë e përcakton se kush nuk mund të jenë kandidatë për bord të RTK-së. Në këtë takim u vendos që të përjashtohen 10 kandidatë për shkak moshës së pensionimit, pavarisht profesionalizimit të tyre, kriter diskualifikues i bazuar në ligj. Po ashtu, Komisioni Ad-Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së, vendosi që t'i drejtohet zyrës ligjore të Kuvendit për disa paqartësi lidhur me aplikimin e disa kandidatëve për anëtarë të Bordit.

Në mbledhjen e fundit të Komisionit Ad – Hoc për përzgjedhjen e bordit të RTK-së, Komisioni Ad-Hoc kishte diskualifikuar nga gara gjithsej 29 kandidatë.

Diskualifikimi i këtyre kandidatëve kishte të bënte kryesisht se disa ishin pensionistë, vinin nga komunitetet tjera (jo serbe), apo se nuk i përmbushnin kriteret tjera teknike të kërkuara me rastin e shpalljes së konkursit (mungesa e dokumentacionit të nevojshëm për të aplikuar në këtë pozitë).

Në takimin e fundit gjithashtu u diskutua edhe për metodologjinë e intervistave. Pyetjet u vendos që të përpilohen ditën kur mbahen intervistat dhe të gjitha pyetjet të jenë të njejta për të gjithë kandidatët, si dhe koha e intervistimit po ashtu. Komisioni po ashtu në këtë mbledhje vendosi që intervistat të jenë të hapura për organizatat e shoqërisë civile, të cilët do të kenë rol monitorues gjatë këtij procesi.

Lëvizja FOL përmes kërkesës për qasje në dokumente publike të drejtuar Kuvendit të Kosovës, kishte kërkuar qasje të plotë në të gjitha dosjet e kandidatëve, të cilët kishin aplikuar për Bord të RTK-së. FOL këto dosje i ka analizuar në aspekt të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore për t'u pranuar në këto pozita, konfliktit të interesit, si dhe sa i përket lidhjeve eventuale me partitë politike. FOL ka gjetur se të gjithë kandidatët të cilët nuk i plotësonin kriteret, janë diskualifikuar qysh në fillim nga komisioni.

FAZA E MBAJTJES SË INTERVISTAVE

Gjatë mbajtjes së intervistave për zgjedhjen e anëtarëve të këtij bordi, anëtarë të panelit intervistues ishin: Armend Zemaj (LDK), Armend Muja (LVV), Saranda Bogujevci (LVV), Duda Balje (Grupi Multietnik), Fitim Uka (LVV), Ardian Gola (LVV), Doarsa Kica – Xhelili (LVV), Albana Bytyçi (AAK) si dhe Mergim Lushtaku (PDK).

Siç ishte planifikuar nga ana e komisionit, intervistat kanë filluar me datën 11 nëntor 2021 dhe kanë zgjatur 5 ditë. Komisioni në ditën e parë të intervistës, kishte vendosur për pyetjet, të cilat janë përpiluar pa prezencën e shoqërisë civile. Komisioni në cilësinë e panelit intervistues vendosi që kandidatëve të ju parashtrohen gjithsej 5 pyetje dhe koha e intervistës të zgjatë jo më shumë se 20 minuta për secilin kandidatë. Po ashtu u vendos që poentimi i secilit deputet të bëhet pas secilës intervistë, në prezencë të monitoruesve nga shoqëria civile.

Në intervistë, ndonëse ishin ftuar gjithsej 102 kandidatë, morren pjesë vetëm 91 prej tyre.

[10] Kuvendi i Kosovës, respektivisht Zyra për Qasje në Dokumenta Publike, kërkuar nga FOL që të bëhet një pagesë në emër të shpenzimeve të materialit, meqë numri i dosjeve kishte kaluar mbi 1000 faqe. Pas gjithë këtyre procedurave, FOL i siguroi gjitha dosjet e të gjithë kandidatëve për intervistë.

Në ditën e parë të intervistave, respektivisht me 11 nëntor 2021, ishin paraparë të intervistoheshin 15 kandidatë, mirëpo u intervistuan vetëm 12 nga ta. Njëra kandidate u diskualifikua qysh në fillim të intervistës nën arsyetimin se një familjare (motra) i punon në RTK dhe së këndejmi paraqet konflikt interesi. Njëra kandidate është vonuar 15 minuta në intervistë, kurse, një kandidat nuk është paraqitur fare për intervistim. Nga 12 kandidatët e intervistuar në ditën e parë, 10 ishin burra ndërsa vetëm dy gra. Poentimi është bërë pas secilës intervistë, në prezencë të monitoruesve, ku secili nga kandidatët është poentuar nga secili deputet deri në 100 pikë.

Dita e dytë e intervistave është mbajtur me datën 12 nëntor 2021. Anëtarët e komisionit për përzgjedhje të Bordit të RTK-së në këtë ditë i kanë intervistuar gjithsej 17 kandidatë, ndërsa një kandidat është tërhequr nga ky proces.

Nga 17 kandidatët e intervistuar, 15 prej tyre ishin burra ndërsa vetëm 2 prej tyre ishin gra. Për të gjithë kandidatët kanë qenë pyetjet e njëjta nga ana e komisionit përzgjedhës dhe po ashtu të gjithë kandidatëve i është dhënë koha e njëjtë për t'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara.

Në ditën e tretë të procesit të intervistimit të kandidatëve, të mbajtur me datë 15 nëntor 2021,

procesit të intervistimit i'u nënshtruan 23 kandidatë, ndërsa 1 kandidat u tërhoq me fillim nga ky proces. Nga 23 kandidatët e intervistuar, 18 prej tyre ishin burra, ndërsa 5 prej tyre ishin gra. Po ashtu edhe gjatë kësaj dite, pyetjet janë parashtruar të njëjta për të gjithë kandidatët dhe thuajse secila intervistë ka zgjatur 20 minuta.

Në ditën e katërt të procesit të intervistimit të kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së, të mbajtur me datë 16 nëntor 2021, u intervistuan gjithsej 18 kandidatë, 10 nga të cilët ishin burra, ndërsa 8 gra. Për dy kandidatë të intervistuar u kërkua nga administrata të konfirmohet nëse të njëjtit janë në konflikt interesi për tu përzgjedhur në këto intervista. Edhe në ditën e katërt procedura e intervistimit ishte e njëjtë për secilin kandidat, me pyetje të njëjta dhe për secilin hapsirë kohore prej 20 minutash për intervistim.

Ditën e fundit të intervistimit të mbajtur me datën 17 nëntor 2021, ishin planifikuar të intervistohen 26 kandidatë, ndërsa në intervistë morrën pjesë vetëm 21 kandidatë. Kjo për shkak se 4 kandidatë nuk kanë ardhur fare në intervistë, ndërsa 1 kandidate është diskualifikuar meqë sipas komisionit ka konflikt interesi sepse një familjar i afërt punon në RTK. Po ashtu, këtë ditë janë intervistuar edhe 4 kandidatë nga komuniteti serb.

Në fund të procesit të intervistimit, anëtarët e komisionit për përzgjedhje të Bordit të RTK-së, deputetët Armend Zemaj, Fitim Uka, Doarsa Kica-Xhelili, Ardian Gola, Mërgim Lushtaku, Saranda Bogujevci, Albana Bytyqi, Duda Balje dhe Armend Muja i kanë rekomanduar Kuvendit për votim listën e kandidatëve për tetë (8) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar dhe për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komunitetit serb, të radhitur sipas rezultateve të poentimit. Komisioni vendosi që të zbatoj Ligjin për Barazi Gjinore [10] dhe ti rekomandojnë Kuvendit një listë me 50% burra dhe 50% gra.

Pas përzgjedhjes së listës së ngushtë, komisioni Ad-Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për Bord të Radio Televizionit të Kosovës (RTK), vendos të largoj nga kjo listë dy kandidatë. Ismet Sijarinës i pamundësohet të qenit pjesë e këtij Bordi, për shkak të interesit financiar. Kjo pasi që në bazë të nenit 27 të Ligjit për RTK-në, paragrafi 1.6 “ka interes financiar të drejtpërdrejtë ose përfaqëson këtë interes, punon ose ka punuar në ndonjë transmetues në punët e telekomunikimit ose të transmetimit dhe në RTK në dy vitet e fundit”. Po ashtu komisioni nga lista e ngushtë e largon edhe kandidaten Arta Pllana për shkak të konfliktit të interesit.

Pas këtyre ndryshimeve në tabelën e mëposhtëme është paraqitur lista e kandidatëve të cilët i janë rekomanduar Kuvendit për votim.

Kandidatët për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kandidatët burra

1. Driton Hetemi
2. Besnik Boletini
3. Ejup Gojnovci
4. Safet Kabashaj
5. Bekim Sele
6. Petrit Çollaku
7. Enis Halimi
8. Gazmend Vitaku

Kandidatet gra

1. Fatime Lumi Qehaja
2. Arta Berisha
3. Albulena Mehmeti
4. Jehona Ademaj-Sejdiu
5. Shukrije Rama
6. Mejreme Krasniqi - Sadiku
7. Mihane Nartilë Salihu Bala
8. Teuta Hoxha - Morina

Kandidatët nga komuniteti serb

1. Mihailo Scepanovic
2. Nelica Veljkovic

Tabela nr. 1. Kandidatët të cilët i ishin rekomanduar Kuvendit të Kosovës për votim nga ana e komisionit përzgjedhës.

Siç u theksua edhe në kornizën ligjore të këtij raporti, zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës bëhet me votim të fshehtë nga deputetët e Kuvendit të Kosovës. Mandati i anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës me short, katër (4) anëtarë të Bordit të RTK-së do të emërohen me mandat dy (2) vjeçar, dy (2) anëtarë me mandat tre (3) vjeçar dhe tre (3) anëtarë me mandat katër (4) vjeçar.

ZGJEDHJA E BORDIT TË RTK-SË NGA ANA E KUVENDIT TË KOSOVËS

Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës në seancën parlamentare të mbajtur më 6 dhjetor 2021 kanë votuar 8 anëtarët e Bordit të ri të Radio Televizionit të Kosovës, 4 prej të cilëve janë burra, ndërsa 4 gra.

Anëtarët e ri të Bordit të RTK-së të përzgjedhur nga ana e kuvendit, janë: Driton Hetemi, Besnik Boletini, Safet Kabashaj, Bekim Sele, Arta Berisha, Albulena Mehmeti, Fatime Lumi-Qehaja dhe Shukrije Rama .

Sa i përket zgjedhjes së anëtarit nga radhët e komunitetit serb, konkursi duhet të përsëritet sepse asnjë nga kandidatët nuk morrën votat e nevojshme për tu zgjedhur në këtë pozitë, siç kërkohet me ligj.

FOL ka monitoruar procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të RTK-së që nga hapja e konkursit dhe duke pasur parasysh që ky ka qenë një ndër proceset më të mëdha të organizuar nga ana e Kuvendit të Kosovës, e ka vlerësuar si proces të rregullt, të hapur dhe transparent. Përmbyllja e këtij procesi me përbërje të barabartë gjinore duhet të vlerësohet jashtëzakonisht shumë dhe duhet të jetë një praktikë që duhet përvetësuar në përzgjedhjen e pozitive tjera nga ana e këtij institucioni.

Pra FOL inkurajon edhe komisionet tjera vlerësuese në kuadër të Kuvendit të Kosovës të respektojnë Ligjin për Barazi Gjinore, në mënyrë që të krijohen mundësi të barabarta për të dy gjinitë.

Në vazhdim e gjeni Aneksin 1 – Lista përfundimtare me pikët e të gjithë kandidatëve të poentuar nga ana e Komisionit Ad – Hoc të Kuvendit të Republikës së Kosovës:

Vlerësimi i kandidatëve nga ana e Komisionit

Kandidati /ja	Armend Zemaj	Albana Bytyçi	Doarsa Kica	Ardian Gola	Fitim Uka	Saranda Bogujevci	Duda Balje	Armend Muja	Mergim Lushtaku	Pikët Finale	Përqindja
Ardiana Marku	90	50	55	65	45	50	60	65	40	520	57.77
Arta Pllana	81	80	86	80	83	70	65	65	60	670	74.44
Albana Krasniqi	65	55	30	40	37	55	55	35	51	423	47
Albert Mirdita	80	50	62	65	54	74	60	60	56	561	62.33
Albulena Mehmeti	90	60	87	92	91	78	80	80	66	724	80.44
Alma Bektashi	75	70	56	65	74	73	65	55	74	607	67.44
Flutura Mehmeti	60	55	33	55	60	30	50	40	54	437	48.55
Arijeta Pozhegu	65	45	58	60	59	45	50	40	48	470	52.22
Arlinda Gropci Xhaferi	40	45	34	65	46	40	50	45	45	410	45.55

Kandidati /ja	Armend Zemaj	Albana Bytyçi	Doarsa Kica	Ardian Gola	Fitim Uka	Saranda Bogujevci	Duda Balje	Armend Muja	Mergim Lushtaku	Pikët Finale	Përqindja
Arlinda Azemi	80	85	67	65	62	75	65	65	65	629	69.88
Armend Vokshi	50	70	83	80	84	68	65	70	62	632	70.22
Arta Berisha	75	55	92	90	88	81	85	90	70	726	80.66
Bardhok Noshi	40	35	38	40	37	39	35	35	23	322	35.77
Bekim Kastrati	75	70	89	80	86	61	85	75	78	699	77.66
Bekim Sele	75	90	94	90	94	78	90	85	72	768	85.33
Bekim Morina	80	65	61	45	74	80	80	80	62	627	69.66
Bekim Samadraxha	90	90	70	75	81	60	75	73	82	696	77.33
Bekim Thaçi	65	55	43	55	49	40	50	45	66	468	52

Kandidati /ja	Armend Zemaj	Albana Bytyçi	Doarsa Kica	Ardian Gola	Fitim Uka	Saranda Bogujevci	Duda Balje	Armend Muja	Mergim Lushtaku	Pikët Finale	Përqindja
Enis Halimi	80	65	80	91	92	82	80	78	78	726	80.66
Besim Gashi	55	60	42	65	73	53	55	50	62	515	57.22
Besnik Aliu	50	50	54	50	63	65	40	45	72	489	54.33
Besnik Boletini	85	90	99	95	96	90	90	88	79	812	90.22
Blerta Zeqiri	85	65	73	77	79	80	75	78	66	678	75.33
Burim Morina	60	65	67	74	74	40	55	70	70	575	63.88
Driton Hetemi	85	95	100	100	94	92	100	95	86	847	94.11
Dush Gashi	70	50	90	75	79	40	55	40	64	563	62.55
Edon Fishekqiu	85	80	73	75	86	65	85	79	66	694	77.11

Kandidati /ja	Armend Zemaj	Albana Bytyçi	Doarsa Kica	Ardian Gola	Fitim Uka	Saranda Bogujevci	Duda Balje	Armend Muja	Mergim Lushtaku	Pikët Finale	Përqindja
Ejup Gojonovci	90	100	77	93	93	79	85	87	88	792	88
Elmije Plakiqi	45	40	42	50	47	45	40	40	52	401	44.55
Agon Kostari	60	40	58	55	45	45	45	60	30	438	48.66
Arben Sahiti	70	65	78	80	86	69	75	73	75	671	74.55
Bedri Krasniqi	70	55	68	60	77	72	75	71	79	627	69.66
Bardhok Bashota	70	85	73	90	84	83	80	78	82	725	80.55
Fadil Maloku	60	75	58	70	67	67	65	71	88	621	69
Fatime Lumi Qehaja	90	80	75	75	83	80	85	82	84	734	81.55
Fatlume Bunjaku	60	40	45	50	37	40	40	48	45	405	45

Kandidati /ja	Armend Zemaj	Albana Bytyçi	Doarsa Kica	Ardian Gola	Fitim Uka	Saranda Bogujevci	Duda Balje	Armend Muja	Mergim Lushtaku	Pikët Finale	Përqindja
Fetah Kasumi	55	55	48	50	66	68	45	63	45	495	55
Florim Isufi	30	30	61	75	77	69	75	78	53	548	60.88
Gazmend Vitaku	85	75	85	75	85	82	85	83	70	725	80.55
Genc Broqi	70	60	68	80	70	69	85	60	73	635	70.55
Jeta Bakija	78	68	68	80	79	55	70	60	58	616	68.44
Gurakuç Kuçi	75	55	74	80	81	70	80	78	77	670	74.44
Ilbrahim Shala	67	90	66	70	72	71	75	71	70	652	72.44
Ilir Gjocaj	60	45	53	60	69	60	60	68	60	535	59.44
Ilir Tolaj	80	65	71	70	86	73	70	76	75	666	74

Kandidati /ja	Armend Zemaj	Albana Bytyqi	Doarsa Kica	Ardian Gola	Fitim Uka	Saranda Bogujevci	Duda Balje	Armend Muja	Mergim Lushtaku	Pikët Finale	Përqindja
Ilirjana Percuku	65	55	56	55	47	56	60	53	64	511	56.77
Imer Topanica	60	50	63	85	87	71	70	70	86	642	71.33
Ismet Mulaj	80	65	73	88	87	67	80	78	70	688	76.44
Ismet Sijarina	85	85	85	71	85	70	90	88	90	749	83.22
Jehona Ademaj- Sejdiu	80	70	77	82	81	70	85	80	79	704	78.22
Jeton Sopa	75	85	63	83	79	80	90	76	48	679	75.44
Kujtim Nushi	70	65	60	75	81	65	60	60	51	587	65.22
Gentiana Mjaku	55	40	54	50	20	49	60	50	50	428	47.55
Kushtrim Osmani	70	80	54	50	49	40	50	45	54	492	54.66

Kandidati /ja	Armend Zemaj	Albana Bytyqi	Doarsa Kica	Ardian Gola	Fitim Uka	Saranda Bogujevci	Duda Balje	Armend Muja	Mergim Lushtaku	Pikët Finale	Përqindja
Lindita Fazliu	70	75	58	60	59	59	60	60	65	566	62.88
Liridona Lluka-Gashi	90	90	71	77	81	79	95	72	79	734	81.55
Lulzim Orana	70	75	79	75	80	69	75	69	70	662	73.55
Lulzim Beqiri	64.5	78	60	55	57	66.5	65	58	72	576	64
Lumnije Ajdini	75	80	70	74	63	65	75	75	83	660	73.33
Mejreme Krasniqi-Sadiku	70	85	74	82	70	65	75	78	84	683	75.88
Mentor Llugaliu	75	70	80	89	88	82	95	79	46	704	78.22
Mevlan Saraçi	80	65	55	60	71	65	75	65	51	587	65.22
Muhamed Simnica	52	50	52	50	69	60	65	58	65	521	57.88

Kandidati /ja	Armend Zemaj	Albana Bytyqi	Doarsa Kica	Ardian Gola	Fitim Uka	Saranda Bogujevci	Duda Balje	Armend Muja	Mergim Lushtaku	Pikët Finale	Përqindja
Myhibije Zallaqi Zhara	75	45	54	50	53	55	57	57	50	496	55.11
Naile Demiri	55	45	54	65	69	50	50	60	56	504	56
Naim Povataj	80	78	48	52	51	30	50	35	69	493	54.77
Naim Zeqiri	70	60	64	55	81	68	65	60	63	586	65.11
Naser Bresa	65	60	66	60	72	55	65	63	62	568	63.11
Naser Sylejmani	80	65	66	60	68	70	75	60	78	622	69.11
Petrit Çollaku	82	90	84	75	89	81	80	80	78	739	82.11
Rrahmil Limani	80	70	64	70	72	65	75	66	73	635	70.55
Sabit Kadriu	80	60	85	70	74	68	75	73	49	634	70.44

Kandidati /ja	Armend Zemaj	Albana Bytyqi	Doarsa Kica	Ardian Gola	Fitim Uka	Saranda Bogujevci	Duda Balje	Armend Muja	Mergim Lushtaku	Pikët Finale	Përqindja
Safet Kabashaj	94	70	92	90	95	90	95	93	78	797	88.55
Shkelzen Osmani	75	70	75	70	81	79	80	77	73	680	75.55
Shkumbin Misini	72	75	70	75	74	64	70	71	79	650	72.22
Shpend Berbatovci	70	55	89	75	80	70	85	80	58	662	73.55
Shpend Dobranja	60	60	60	55	62	65	70	55	67	554	61.55
Shukrije Rama	89	80	67	71	79	65	85	68	80	684	76
Teuta Hoxha Morina	89	85	67	60	75	55	75	66	84	656	72.88
Visar Xani	90	70	75	65	67	62	65	60	84	638	70.88
Vlora Konushevci	70	70	75	55	67	55	70	65	45	572	63.55

Kandidati /ja	Armend Zemaj	Albana Bytyqi	Doarsa Kica	Ardian Gola	Fitim Uka	Saranda Bogujevci	Duda Balje	Armend Muja	Mergim Lushtaku	Pikët Finale	Përqindja
Xhemshit Brajshori	67	50	60	50	66	52	55	53	58	511	56.77
Xhevat Parduzi	60	30	56	65	42	40	55	35	48	431	47.88
Xhevdet Doda	90	75	71	65	70	40	95	50	59	615	68.33
Yll Bislimi	89	85	61	60	64	65	70	63	57	614	68.22
Halit Veliu	70	40	61	55	69	50	55	48	51	499	55.44
Ljubomir Stanojkovic	75	75	70	80	79	70	75	75	78	677	75.22
Nelica Veljkovic	75	83	85	75	77	70	75	75	62	677	75.22
Mihailo Scepanovic	85	75	82	90	81	95	90	85	52	735	81.66
Dragan Cirkovic	60	50	60	40	45	50	35	55	45	440	48.88
Mihane Nertile Salihu Bala	80	60	79	80	74	67	75	83	70	668	74.22

Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është përkrahur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Suedia, dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Lëvizjes FOL dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së, Suedisë apo Luksemburgut.

